



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 1276/3 Prot.

Tiranë, më 21.05.2025

**KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KRITERET PARAPRAKE PËR THIRRJEN
SHPALLJE NJOFTIMI PËR VENDE TË LIRA PUNE NË QENDRËN E
SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TIRANË**

Komisioni për zhvillimin e procesit të konkurimit për vende të lirë pune në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë, ngritur me Urdhrin nr. 326, datë 19.05.2025, të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, u mblodh më datë 21.05.2025, me qëllim shqyrtimin e aplikimeve, sa i përket përmbushjes së kërkesave të posaçme dhe dokumentacionit sipas thirrjes së publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, si dhe në bazë të Urdhrit nr. 53, datë 26.05.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore”.

- Nga verifikimi në protokoll, rezulton se për vendin vakant pranë **Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë** kanë shprehur interes **2 (dy) aplikantë** si vijon:

1. Zj. Gilda Turku

(kërkesa me nr. 1307 prot, datë 19.05.2025, me anë të shërbimit postar);

2. Zj. Dajana Sokoli

(kërkesa me nr. 1340 prot, datë 19.05.2025, me anë të shërbimit postar);

Pas shqyrtimit të dosjeve personale të aplikantëve, sipas metodologjisë së vlerësimit, Aneks-it 1 të miratuar me urdhërin nr. 53, datë 26.05.2021 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës parësore”, komisioni vendosi që aplikantët të cilët plotësojnë kriteret për të vazhduar procesin e konkurimit (sipas rendit alfabetik) janë:

1. Zj. Dajana Sokoli

2. Zj. Gilda Turku

- ❖ Aplikantët e kualifikuar për shpalljen: “Për vende të lirë pune në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë”, duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (Rruga “Jordan Misja”, Njësia Bashkiake nr. 9, Godina nr.3, Tiranë), për t’iu nënshtruar provimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

- ❖ **Provimi me shkrim** do të zhvillohet më datë **23.05.2025, ora 10:30**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Provimi me shkrim do të zhvillohet mbi:

- Njohuri të thelluara mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Ligjin nr.111/2017, kushtet dhe kërkesat e ligjit për të përfituar nga shërbimet e ndihmës juridike falas dhe aktet nënligjore, të cilat mund ti aksesoni në faqen zyrtare <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/legjislacion/>

- ❖ **Intervista e strukturuar me gojë** do të zhvillohet më datë **23.05.2025, ora 11:45**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet mbi:

- Njohuritë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e punës, eksperiencën e mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Mos paraqitja e kandidatëve në datën e orën e caktuar passjell skualifikimin.

Adresa: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Rruga “*Jordan Misja*”, Njësia Bashkiake nr. 9,
Godina nr.3, Tiranë